



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Raporti vjetor i Vetëvlerësimit

2012-2013

*Ky raport mbulon periudhën kohore 1
shtator 2012 deri 31 gusht 2013*

Tetovë, Maqedoni
Nëntor 2013

Përmbajtja

1.0 Hyrje	3
2.0 Të arriturat	5
3.0 Struktura, fakultetet dhe qendrat	6
3.1 Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë	6
3.2 Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore	7
3.3 Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit	8
3.4 Fakulteti i Drejtësisë	9
3.5 Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike	10
3.6 Qendra e gjuhëve	10
3.7 Qendra e mësimit në distancë (<i>e-Learning</i>)	11
3.8 Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit	12
4.0 Sigurimi i cilësisë	12
5.0 Mësimdhënia dhe të nxënit	14
5.1 Programet dhe statusi	14
5.2 Regjistrimi i studentëve	14
5.3 Kalueshmëria e studentëve	16
5.4 Shkalla e diplomimit	17
5.5 Vlerësimi i stafit akademik nga studentët	17
5.6 Qendra e karrierës	18
5.7 Asociacioni i Alumnit	19
6.0 Hulumtimi	20
6.1 Marrëdhëniet ndërkombëtare	21
7.0 Ndërmarrësia dhe zhvillimi	22
8.0 Financimi	23
9.0 Mjedisi dhe shërbimet në kampus	23
9.1 Përkrahja e studentëve	23
9.2 Ngrehinat&kapacitet teknike	24
9.3 Qendra e UEJL-së në Shkup	25
9.4 Burimet njerëzore	26
9.5 Sistemet e informacionit	27
9.6 Biblioteka	28
9.7 Parlamenti i Studentëve	28
9.8 Sporti dhe rekreacioni	28
10.0 Përfundimet	30

1.0 Hyrje

Ky raport përfshin periudhën kohore nga 1 shtatori 2012 deri në 31 gusht 2013. Gjatë kësaj periudhe, Universiteti ka shënuar përvjetorin e njëmbëdhjetë. Universiteti mbetet institucion i arsimit të lartë konkurrues, ndërkombëtarisht i orientuar me reputacion solid për cilësinë dhe me një numër në rritje të kontakteve ndërkombëtare.

Pesë fakultetet e Universitetit e kanë fokusuar punën e tyre në ofrimin e programeve që janë konzistente me ato të modeleve ndërkombëtare për të ofruar shkathtësi që lidhen me tregun e punës për të diplomuarit. Të gjitha fakultetet kanë implementuar procedurat bazike të sigurimit të cilësisë, si vëzhgimi i mësimdhënies për të gjithë stafin akademik dhe vlerësimin nga studentët, si mekanizma të ngjashëm me ato të hapësirës së arsimit të lartë të Bolonjës dhe Amerikës Veriore. Universiteti, gjithashtu është pionier rajonal në mësimin në distancë (*e-Learning*), me sistem të avancuar të menaxhimit të të nxënit dhe mundësive në rritje të mësimdhënies online.

Kriza e vazhdueshme ekonomike në rajon dhe në botë, gjithashtu ka paraqitur sfida specifike për Universitetin. Shumë njerëz ballafaqohen me vështirësi financiare dhe sa më pak anëtarë të familjeve nga diaspora janë në gjendje të dërgojnë 'remitanca' familjeve të tyre në Republikën e Maqedonisë. Disa studentë që do të dëshironin të ndiqnin studimet në UEJL e kanë të vështirë përballimin e kostos së shkollimit. Disperzimi i institucioneve të arsimit të lartë në RM, gjithashtu e bën regjistrimin e studentëve një proces edhe më të vështirë.

Ne vazhdojmë të ofrojmë programe studimore në të dy kampuset dhe të investojmë në infrastrukturën e duhur për t'u ofruar studentëve klasa dhe teknologji të përshtatshme dhe miqësore. Për të gjithë stafin është ofruar trajnim profesional, qoftë sesione trajnimi një orësh, qoftë trajnime vjetore, ku së bashku stafi akademik dhe administrativ diskutojnë për studimet, planifikimin dhe reflektojnë mbi këto çështje. Gjithashtu, të gjithë anëtarët e stafit takohen personalisht me menaxherët e tyre të drejtpërdrejtë akademik ose administrativ për konsultime personale dhe për vendosjen e targeteve specifike për vitin e ardhshëm. Universiteti edhe më tej mbetet i përkushtuar për përdorimin shumëgjuhësi, duke u ofruar studentëve dhe stafit udhëzime në shqip, maqedonisht ose anglisht, ashtu siç kërkojnë ose dëshirojnë individët.

UEJL mbetet i përkushtuar në shërbimin konsistent të cilësisë së lartë për studentët. Përveç programeve akademike që ndjekin studentët, Universiteti implementon disa metoda për të rritur të nxënit dhe kënaqësinë e studentëve. Të gjithë studentët anketohen në mënyrë anonime në opinionet e tyre për mësimdhënësit dhe në përgjithësi për Universitetin; këto rezultate drejtpërsëdrejti janë futur në planveprimet e departamenteve. Parlamenti Studentor gjatë këtij viti është transferuar në premisa të reja në kampusin në Tetovë dhe ka mbajtur zgjedhje për përfaqësuesit e ri. Studentët e UEJL-së kanë marrë pjesë në programet e lëvizshmërisë dhe në vizita vendeve që ju ndihmojnë atyre të aplikojnë njohuritë e tyre teorike me kërkesat e botës profesionale. 'Panairi i karrierës' u mbajt në maj, duke mundësuar që studentët dhe punëdhënësit potencial të takohen dhe shkëmbejnë ide.

Përfundimisht, shumë studentë me përpjekjet e tyre kanë shkëlqyer në ngjarjet sportive, duke dalluar veten dhe ne.

Me gjithë vazhdimin e krizës financiare, konkurrencën e rritur me disperizimin dhe vështirësitë shoqëruese që paraqesin këta faktorë për rekrutimin, UEJL ruan një reputacion për cilësinë, shërbimin për studentët dhe një paraqitje të vërtetë ndërkombëtare.

Këtë vit (2013-2014), të dhënat nga regjistrimi/aplikimi tregojnë për një rritje të përgjithshme prej rreth 18% të aplikacioneve në krahasim me vitin e kaluar. Kjo konfirmon përkushtimin e UEJL-së për cilësinë dhe kështu, Universiteti ka vazhduar të demonstrojë një angazhim për vizionin e themeluesve të tij - universitet i qëndrueshëm, me cilësi të lartë me orientim ndërkombëtar.

2.0 Të arriturat

Gjatë vitit akademik 2012-2013, Universiteti ka shënuar disa arritje të dukshme në akreditimin e ofertave të reja akademike. Universiteti ka parashtruar kërkesën dhe me sukses ka akredituar shkollën e doktoraturës (do të fillojë në nëntor 2013), me çka UEJL fiton të drejtën për të ofruar studime në tri ciklet e arsimit të lartë. Universiteti ka akredituar disa programe, për herë të parë sipas sistemit arsimor gjerman, ku puna praktike me kompanitë është integruar në kurrikulat që ndiqen nga studentët; kompanitë ofrojnë bursa për t'i ndihmuar këta studentë.

Regjistrimet janë në nivel të duhur, duke pasur parasysh disperzimin e instucioneve konkurrenente, krizën ekonomike dhe ndryshimet demografike në shtet. Një gjë që veçanërisht duhet konstatuar është fama në rritje e programeve studimore që ofrohen në gjuhën angleze. Taani, afro 30% e studentëve të UEJL-së studiojnë në anglisht, që është një tregues i rëndësishëm i fokusit të suksesshëm të ndërkombëtarizimit të UEJL-së.

Një nga zhvillimet kryesore infrastrukturore ka ndodhur në maj 2013, kur në kampusin e UEJL-së në Tetovë u hap Parku Teknologjik. Parku Teknologjik synon të kombinojë ekspertizën dhe mbështetjen e Universitetit me shkathtësitë sipërmarrëse dhe vizionin e biznesit të kompanive vendore. Ky zhvillim ilustron synimin tonë për të lidhur komunitetin e biznesit me akademinë, si dhe për të siguruar për palët e interesuara përafrimin me shkathtësitë dhe njohuritë me zhvillimet e fundit të tregut dhe kërkesave.

Në mënyrë që të ofrojmë përvojë të ngjashme praktike për studentët, kemi nënshkruar dy memorandume relevante këtë vit. I pari me Odën Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, për të promovuar programet e studimit të integruar me mundësitë e biznesit, kurse memorandumit i dytë me Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë. Kjo do të lejojë që studentët tanë të aplikojnë për internship në fusha të ndryshme të administruara nga Ministria dhe për të marrë përvojën e vërtetë në një departament të madh qeveritar.

UEJL gjithashtu është i vendosur për të siguruar udhëheqje rajonale në fushën e energjisë së qëndrueshme. Më 26 qershor 2013, inauguruam impiantin fotovoltai, i cili siguron kampusin e Tetovës me energji nga burime të ripërtërishme. Ky angazhim u pasua nga një njohje e sërishme, tre muaj më vonë, përmes një memorandumi të nënshkruar me kryetaren e komunës së Tetovës për të promovuar Planveprimin klimatik të Komunës.

Universiteti me mbështetjen e Qeverisë Federale Gjermane punoi në dizajnimin e një programi deridiplomik të dyfishtë që integron biznesin me akademinë. Ky program ka filluar dhe ka 14 studentë, të gjithë të mbështetur plotësisht me bursa nga bizneset lokale. Në mënyrë të ngjashme, "Ecolog" ka ndihmuar programin e magjistraturës Menaxhimi me projekte, ku janë dizajnuar 13 bursa për nevojat e tyre të biznesit.

Infrastruktura në Qendrën e UEJL-së në Shkup është përmirësuar. Universiteti ka rënë dakord për transformimin Qendrës së UEJ-Shkup në një ndërtesë të re, më të madhe, një ndërtesë mu në qendër, me çka është realizuar rinovimi i plotë i objektit për të përmbushur

standardet më të larta për hapësirë në klasa. Hapësira e re ka një vend simbolik në zemër të qytetit që është quajtur 'URA', kështu vet emri fjalë për fjalë paraqet një urë që bashkon dy pjesët e kryeqytetit ('Qendrën' dhe 'Çairin'). Ky vend do të sigurojë afërsisht tri herë më shumë hapësirë se në premisat e mëparshme.

Së fundi, ne kemi qenë të privilegjuar të presim mysafirë nga i gjithë shteti, rajon dhe bota në konferenca të shumta akademike, diskutime në tryeza të rrumbullakëta dhe seminare. Pjesëmarrja e tyre ka sjellë ekspertizën e tyre në universitetin tonë, si dhe kolegjaliteti dhe aftësitë e tyre kanë gjallëruar dhe pasuruar diskutimet tona.

UEJL me arsye është krenar për të regjistruar këto arritje, veçanërisht si një institucion i ri dhe në rritje.

3.0 Struktura: Fakultetet dhe Qendrat

Universiteti i Evropës Juglindore vazhdon ta ruajë strukturën me pesë fakultete, si: Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore, Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike. Studentët studiojnë kryesisht në kuadër të fakulteteve të tyre (ata gjithashtu ndjekin lëndë 'zgjedhore të lira', të cilat janë në dispozicion për studentët nga çdo fakultet). Dy qendrat autonome sigurojnë mësimdhënie shtesë për anëtarët e të gjitha fakulteteve: Qendra e gjuhëve, e cila siguron mësimdhënie të gjuhëve për studentët dhe stafin; dhe Qendra e mësimin në distancë (e-Learning), e cila ofron trajnime kompjuterike dhe mbështetje. Së fundi, janë edhe dy institute hulumtuese që ndihmojnë për të koordinuar përpjekjet e Universitetit në hulumtim.

3.1 Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë këtë vit i ka kushtuar vëmendje të veçantë promovimit të cilësisë në mësimdhënie dhe shërbimit të studentëve. Procesi i vëzhgimit të mësimdhënies plotësisht është implementuar dhe 5 anëtarë të stafit të FBE kanë qenë në Ekipin qendror të vëzhguesve të Universitetit.

Në mënyrë që të mbajë një nivel të lartë të hartimit të programeve studimore dhe mbështetje, fakulteti ka akredituar një program të ri të ciklit të dytë-menaxhimi i projekteve. Ky program është dizajnuar në bashkëpunim me kompaninë "Ecolog", kështu duke siguruar se programet tona akademike i plotësojnë kërkesat e biznesit real. Fakulteti ka hartuar dhe ka akredituar programin për studimet e doktoratës. FBE me sukses ka ofruar programin e magjistraturës në Administrim Biznesi. Programi MBA është një ndër programet kryesore të arsimimit në biznes në perëndim, si një ofertë unike brenda rajonit. Vlera e shtuar e këtij programi është në atë se ofrohet në bashkëpunim me Shkollën e Biznesit Kelly të Universitetit të Indianës, si një nga 20 shkollat më të mira në nivel botëror. Studentët në vitin e dytë të këtij programi udhëzohen nga ana e profesorëve të Universitetit të Indianës dhe do të marrin certifikatat e lëshuara nga KBS për çdo lëndë.

Edhe me tej, programet Administrim biznesi dhe Ekonomi, mbeten më popullore në studimet deridiplomike, gjë që dëshmohet me të dhënat nga regjistrimi. Në studimet e

magjistraturës, Menaxhmenti, Financat dhe Kontabiliteti dhe Menaxhimi me projekte, të gjitha tregojnë nivel të mirë të regjistrimeve.

Qëllimi i fakultetit është që të punojë në rritjen e regjistrimeve në vitin e ardhshëm, pasi kohëve të fundit ka rënie të regjistrimeve nga rajoni Gostivar-Tetovë. Qëllimi kryesor i fakultetit është të përmirësojë rekrutimin, duke krijuar lidhje të ngushta me shkollat e mesme rajonale, duke futur në programin e promovimit të Fakultetit aktivitete specifike promovuese dhe edukative për komunitetin; dhe krijimin e lidhjeve më të ngushta me grupet e interesit në sektorin e biznesit lokal.

Si pjesë e kësaj përpjekjeje, disa anëtarë të stafit BE kanë ofruar trajnime nga 27 deri 30 maj 2013, për të mbështetur punësimin e të rinjve. Kjo përpjekje solli së bashku stafin akademik, udhëheqësit e bizneseve lokale dhe studentët të cilët fituan shkathtësi për punë veçanërisht ata që synojnë të hyjnë në tregun e punës së biznesit. Ky trajnim u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë. Së fundi, fakulteti ka punuar në bashkëpunim me QZHB-në për të ofruar trajnime për bizneset dhe ka hartuar një plan trajnime për vitin e ardhshëm.

3.2 Fakulteti Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore

Fakulteti Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore ka ruajtur pozitën udhëheqëse si fakultet inovativ dhe studenti-në qendër në lëmin e mësimdhënies në shkencat kompjuterike dhe teknologjike. Ka identifikuar si një nga qëllimet e tij kryesore bashkimin në rritje të njohurive teorike me përvojën praktike. Së fundi, ka organizuar shkollën verore mbi tendencat e ardhshme në shkencat kompjuterike.

Fakulteti ka promovuar fuqishëm bashkimin e praktikës dhe të studimit, duke identifikuar, krijuar dhe akredituar programe të reja akademike. Këto janë të dizajnuara për të ndihmuar të diplomuarit që të jenë të gatshëm për tregun e punës, që shkathtësitë e tyre të përputhen me sfidat praktike të punës moderne. Theksi i këtyre programeve është integrimi i përvojës dhe punës në klasë/laborator studimi. Fakulteti ka kënaqësinë të konstatojë që mban normë të lartë të punësimit të të diplomuarve të tij në nivel rajonal.

Për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar, tre përfaqësues të Fakultetit vizituan Universitetin Linnaeus në Suedi, për të ndërtuar partneritet dhe për të promovuar lëvizshmërinë e stafit. Përveç kësaj, Fakulteti i SHTB inkurajon dhe mbështet studentët për të marrë pjesë në programet e lëvizshmërisë; vitin e kaluar kishte vetëm gjashtë mundësi të tilla shkëmbimi për studentët e SHTB.

Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore ka bërë përpjekje të rëndësishme për të përmirësuar rëndësinë e vet në rajon, duke u angazhuar në përpjekjet e shumta promovuese për rekrutimin e studentëve në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri. SHTB, gjithashtu ka mbështetur edhe pjesëmarrjen e stafit në konferenca dhe tryeza të rrumbullakëta, për të rritur njohuritë e tyre dhe për të ndërtuar kontakte profesionale, si dhe ka organizuar një shkollë verore në tendencat e ardhshme në shkencat kompjuterike. Ka vazhduar t'i mbajë "grupet hulumtuese" specifike për limitet e Fakultetit të themeluara në vitin e kaluar. Në kuadër të "grupe hulumtuese", gjashtë projekte hulumtuese janë dorëzuar

për financim të jashtëm dhe dy prej tyre kanë fituar. Fakulteti vazhdon të mbështesë stafin për propozime kërkimore me qëllim kryesor të gjetjes së fondeve të jashtme, si dhe rritjen e fisibilitetit të Fakultetit, si në nivel kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Fakulteti vazhdon të besojë se harmonizimi i politikave dhe procedurave është një element kyç në ofrimin efektiv dhe efikas të mësimdhënies për studentët. Si objektiva për të ardhmen, kërkon të vazhdojë në ndërtimin e lidhjeve të forta me grupet e interesit profesional; të mbajë normë të mirë të punësimit për të diplomuarit dhe të promovojë kompetencë të bazuar në të nxënit në të gjitha ciklet.

3.3 Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit vazhdon të ofrojë mësim në katër fusha gjerësisht të lidhura: Gjuhë dhe letërsi shqipe; Gjuhë dhe letërsi angleze; Gjuhë dhe letërsi gjermane; dhe Komunikim ndërkombëtar. Fakulteti kryesisht ofron lëndë për zhvillimin e shkathtësive gjuhësore, mësim pedagogjik, media dhe shkathtësi të komunikimit. Kjo ofertë ka për qëllim që të diplomuarit të jenë kompetent për t'u punësuar në një shumëllojshmëri të gjerë të profesioneve për të cilat aftësitë komunikuese janë parësore.

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe ka qenë veçanërisht aktive gjatë periudhës së konsideruar në këtë raport, ashtu sikurse gjatë kësaj kohe Shqipëria festoi përvjetorin e njëqindtë të pavarësisë së saj. Departamenti organizoi një konferencë të madhe ndërkombëtare që mblodhi së bashku albanologë nga i gjithë rajoni për bisedime plenare dhe sesione paralele për prezantimin e punimeve.

Komunikimi ndërkombëtar ishte një program i ri në 2012-2013, dhe përfaqësonte një ofertë të re në rajon. Vitin e parë kishte normë të lartë regjistrimeve 20 studentë në Tetovë dhe 11 studentë në Shkup. Gjatë vitit, programi i ri në studimet magjistraturës në komunikimin ndërkombëtar u akreditua gjithashtu dhe filloi në vitin akademik 2013-2014. Gjithashtu, në zhvillim të programit kishte folës mysafirë shumë të shquar, të cilët sollën përvojën e tyre ndërkombëtare dhe ndanë perspektivat me studentët.

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane vazhdoi me regjistrime të qëndrueshme. Vazhdojnë lidhjet e ngushta me ZUG-un e Zvicrës dhe të dy palët kanë pritur studentët, si UEJL edhe ZUG, ka dërguar disa studentë në UEJL.

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze kanë shënuar zvogëlim të regjistrimeve në studimet deridiplomike, por ka pasur rritje të dukshme të regjistrimeve në studimet e magjistraturës. Departamenti ka organizuar disa sesione trajnimi dhe seminare në anglisht, të lidhura me tema të tilla si metodologjitë e mësimdhënies së EFL dhe punën e poetes amerikane Sylvia Plath. Departamenti ka vendosur që gjithashtu të ofrojë programin e gjuhës angleze në Shkup dhe kjo filloi në vitin akademik 2013-2014. Dy anëtarë të Departamentit të gjuhës angleze kanë fituar bursa ndërkombëtare për hulumtim jashtë vendit.

Iniciativat kryesore të fakultet në këtë vit kanë qenë mbajtja e konferencave dhe seminareve; përmirësimi dhe monitorimi i 'mësimin klinik' (prezantime nga ligjërues mysafir); dhe duke rritur praninë e Fakultetit në shkollat lokale të promovojë studimin e gjuhëve dhe rekrutimin e studentëve të rinj për programet e Fakultetit të GJKK. Si fusha për

përmirësim, Fakulteti ka identifikuar rritjen e regjistrimeve të studentëve; rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në programin e lëvizshmërisë ERASMUS; përmirësimin e mbështetjes për studentët me korrespondencë; dhe përmirësimin progresionit të studentëve nga viti në vit, siç matet nga diplomimi në kohë.

3.4 Fakulteti i Drejtësisë

Fakulteti i Drejtësisë ka vazhduar me implementimin e kurrikulave të forta në të dy ciklet e studimit. Këshilli i Fakultetit takohet rregullisht për të vlerësuar ofertën akademike, për të sugjeruar përmirësime, si dhe për të siguruar pajtueshmëri të plotë me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Maqedonisë.

Hulumtimi nga ana e stafit vazhdon të përmirësohet. Mësimdhënësit janë inkurajuar për të rritur pjesëmarrjen e tyre në konferenca dhe publikime dhe shumë anëtarë e kanë bërë këtë. Fakulteti është i kënaqur gjithashtu se disa prej anëtarëve më të rinj kanë marrë, ose janë gati për të mbrojtur, doktoraturën. Ky progres është në përputhje me qëllimin e Universitetit për të ndihmuar përparimin akademik përmes aplikimit të standardeve rigoroze dhe arritjeve akademike.

Fakulteti vazhdon të mbajë një përzierje të fortë të profesorëve të shquar të moshuar dhe studiuesit e ri premtues. Përveç kësaj, Fakulteti vendosmërisht beson në sjelljen në mësim praktik gjyqtar të shquar, studiues, dhe avokatë. Duke ndjekur këtë politikë, ne besojmë që se ofrojmë arsimim të gjerë dhe gjithëpërfshirëse juridik të përshtatshëm për ata që synojnë të hyjnë në praktikën juridike ose për të ndjekur studime avancuara juridike.

Fakulteti ka dhënë kontributin më të madh nga universitetet e Republikës së Maqedonisë për projektin *World Justice Project Rule of Law Index 2012-2013*. Projekt, i cili pjesërisht financohet nga Fondacioni Bill dhe Melinda Gates, realizohet në 97 vende, një studim për aplikimin e mirëfilltë të sundimit të ligjit në ato vende.

Fakulteti realizoi një vizitë studimore në Spanjë gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport. Studentët e fakultetit, të shoqëruar nga katër profesorët e fakultetit, vizituan Senatin e Kortesit spanjoll në Madrid. Po ashtu, në Madrid u vizitua edhe Fakulteti Juridik i Universitetit Autonom të Madridit, ku u priten nga ana e dekanit të këtij fakulteti Prof. Dr. Fernando Molina Fernandez. Në Barcelonë u vizitua Fakulteti juridik i Universitetit Autonom të Barcelonës, edhe Parlamenti i Komunitetit Autonom të Katalonisë.

Fakulteti i Drejtësisë ka bërë rekrutimin studentëve të ri pjesë të rëndësishme të punës së tij për këtë vit. Ekipet e veçanta kanë qenë prezent në shkollat e mesme, në mënyrë për të tërhequr studentët më të mirë nga rajoni. Në mënyrë të ngjashme, shërbimi dhe konsultimi me studentët është mbajtur dhe është verifikuar nga dekanati.

Në pjesën e regjistrimeve për vitin e ri akademik, është shënuar rënie në numrin e studentëve me mësim në gjuhën maqedonase në Shkup. Si përgjigje, fakulteti e ka përfshirë këtë çështje në Planveprim, si qëllim specifik për të bërë përpjekje marketingu për të promovuar ofrimin programeve në gjuhën maqedonase në Shkup. Në mënyrë të ngjashme,

një nga hapat e ardhshëm në rritje është perspektiva ndërkombëtare e Fakultetit të Drejtësisë, për të punuar më afër me Institutin Maks Van der Shtul në promovimin e programeve ndërkombëtare të magistraturës në këtë fushë.

3.5 Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike

Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike është përpjekur për të mbajtur cilësi të lartë në programet akademike, duke krijuar programe të reja me zbatueshmëri lokale dhe rajonale. Stafi APSHP beson se suksesi i ofertave të tyre akademike do të jetë në sigurimin e mësimit në nivel lokal, por me relevancë ndërkombëtare. Për këtë qëllim, Fakulteti nënshkroi një marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi Erasmus me Departamentin e Shkencave Sociale të Universitetit të Lubjanës; ku është akredituar programi i përbashkët me Universitetin e Lubjanës dhe ka akredituar një program të përbashkët me Universitetin Jönköping në Suedi. Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike gjithashtu, ka hartuar, propozuar dhe akredituar studimet e doktoraturës, të cilët do të fillojnë në vitin akademik 2013-2014.

Në mënyrë që të ofrojë shërbimin më të mirë për studentët, Fakulteti ka themeluar grupeve të veçanta për të zhvilluar rezultatet e pritura nga mësimi për çdo program. Menaxhmenti i Fakultetit gjithashtu është angazhuar për një rishikim të gjerë të rezultateve të vlerësimit nga studentët dhe u takua me të gjithë anëtarët e stafit për të diskutuar përmirësimet e reja në përdorimin e materialeve, përdorimin e LIBRIT, dhe metodat e vlerësimit. Stafi me kohë të plotë i APSHP gjithashtu ka marrë pjesë në procesin e vëzhgimit të mësimdhënies të Universitetit. Të gjitha këto të dhëna janë inkuadruar në vlerësimin vjetor të stafit, në mënyrë që të krijojë objektiva realiste, por të rëndësishme për përmirësimin e shërbimit studentëve.

Fakulteti ka ndërmarrë hapa të vazhdueshëm për të promovuar rregullsinë e procedurave, analizën e hapur të të dhënave dhe shkëmbimin e lirë të ideve gjatë takimeve të Këshillit të Fakultetit. Fakulteti ka ndërmend të ndërmarrë aktiviteteve specifike të rekrutimit dhe të ndërtuar lidhje të mëtejshme me partnerët lokal dhe rajonal. Stafi APSHP ka vërejtur rënie në regjistrime në disa grupe apo programeve dhe kërkon të bëjë përpjekje të veçanta për të promovuar këto programe, në mënyrë që të arrijnë një rritje në regjistrimin e studentëve, veçanërisht në studimet deridiplomike.

Fakulteti APSHP gjithashtu është përkushtuar për hulumtimin. Një nga qëllimet specifike të Fakultetit në vitin e ardhshëm është për të krijuar grupeve hulumtuese për një disiplinë specifike dhe në bashkëpunim me Institutin hulumtues Maks Van der Shtul, të nxit synimin për grantet specifike të hulumtimit dhe propozimeve të përshtatshme për hulumtimin dhe ekspertizën e Fakultetit.

3.6 Qendra e gjuhëve

Qendra e gjuhëve (QGJ) ka zhvilluar e aktivitetet e saj në dy fusha kryesore: programi akademik dhe programi i shërbimeve për komunitetin. Programi akademik u pasurua me ofertën e lëndëve 'zgjedhore të lira' në gjuhën shqipe, angleze, maqedonase, frëngjisht dhe gjermanisht. Këto lëndë gëzojnë interes të konsiderueshëm në mesin e studentëve, siç

dëshmohej nga numrat e studentëve të regjistruar. QGJ organizon provime me gojë për të gjithë studentët dhe të gjitha lëndët që ofron. Testi i njohjes së gjuhës angleze, i realizuar në fillim dhe në fund të semestrit të pranveror 2013, tregon një shkallë të lartë të përmirësimit të njohjes së gjuhës angleze (85% e studentëve kanë rritur rezultatin e tyre pas mësimit 4 mujor të gjuhës angleze). Shkalla e pjesëmarrjes në Shkollën Verore gjithashtu ishte e lartë (153 studentë). Si pjesë e fushatës së promovimit të Universitetit, QGJ organizoi konkursin kombëtar për ese ku kishte afërsisht 300 pjesëmarrës nga i gjithë vendi, tubimin e fundit në Qendrën e Gjuhëve me 8 mars. Në këtë ceremoni, studentët e UEJL-së kanë performuar për kolegët e tyre — ku kishte shumë studentë nga pjesë të ndryshme të Maqedonisë, prindërit e tyre dhe mësuesit e gjuhës angleze.

Si pjesë e programit të shërbimit për komunitetin, QGJ ka organizuar disa sesione të kurseve përgatitore TOEFL dhe testimin, pasi u licencuan për provimin TOEFL ITP (me shkrim). Kursi CELTA u kompletua me 11 kandidatë dhe kishte një raport të shkëlqyer në lidhje me organizimin e kursit nga Qendra Cambridge. Për më tepër, QGJ vazhdon të ofrojë kurse të gjuhës shqipe për stafin e ambasadës amerikane dhe kurse të gjuhës angleze për stafin e Pro-Credit Bank-ës.

Sfida më e madhe për QGJ, në fushën akademike, mbetet krijimi i një provimi formal të detyrueshëm në fund për të gjithë studentët para diplomimit. QGJ shpreson për të zgjeruar përpjekjet për informim të komunitetit, sidomos duke rritur kontaktet me ministrinë dhe institucionet e ndryshme të sektorit publik, në mënyrë që për të njëjti të organizojë kurse të gjuhës.

3.7 Qendra e mësimit në distancë (eLearning)

Qendra e mësimit në distancë (eLearning), në nivel të Universitetit ofron shërbime në tri degë kryesore:

E para, është ofrimi i një shumëllojshmërie të lëndëve për trajnime TI që u japin studentëve shkathtësitë e nevojshme kompjuterike për karrierën e tyre të ardhshme. Lëndët e lira-zgjedhore që ofrohen nga Qendra eLearning, mbulojnë një larmi temash në mënyrë që të përmbushin nivele të ndryshme të shkathtësive dhe interesave. Kurset hyrëse të trajnimit ofrohen për ata studentë që kërkojnë njohuri bazike, ndërsa kurse më të avancuara të aplikacioneve të fundit ofrohen për studentët me nevoja më të sofistikuar dhe të specializuara. Të gjitha këto kurse, ofrohen për stafin akademik dhe administrativ. Qëllimi është të ofruarit e njohurive, shkathtësive teknike dhe përvijës që të rrisë vlerën e secilit anëtar të komunitetit të UEJL-së në institucion dhe në të njëjtën kohë, të përkrah zhvillimin e tyre profesional.

Segmenti i dytë i aktiviteteve të eLearning, është të mirëmbajë dhe monitorojë punën e *Learning Management System – Libri*. Për këtë aktivitet, stafi i Qendrës eLearning ofron mbështetje të vazhdueshme efikase për të gjithë anëtarët e stafit akademik për menaxhimin e lëndëve të tyre në Libri. Në aspektin e rritjes së cilësisë së përmbajtjes së lëndëve, raportet e ndryshme mund të gjenerohen për çdo lloj veprimtarie në Libri.

Segmenti i fundit, Qendra eLearning mbështet studimet online në UEJL. Me qëllim që të përmirësojë shërbimin tonë për studentët dhe për të qenë konkurrues në nivel

ndërkombëtar, studimet online që u themeluan në vitin 2011, duhet të vazhdojnë të jenë një nga sferat kryesore të vëmendjes së Qendrës eLearning. Qendra eLearning vazhdon të ofrojë trajnime për mjetet dhe metodologjinë mësimore online. Numri i studentëve online në UEJL është duke u rritur.

Ndër këto tri fusha të përgjegjësisë, Qendra eLearning bashkëpunon pothuajse në çdo aktivitet në nivel të Universitetit ku kërkohet një ekspertizë e tillë.

3.8 Instituti i Mjedisit Jetësor dhe Shëndetin

Instituti i Mjedisit Jetësor dhe Shëndetin shënoi dy suksese të dukshme këtë vit, në ndjekje të Planveprimit klimatik të UEJL-së. I pari, ishte ndërtimi dhe përrurimi i impiantit fotovoltaik në kampusin e Tetovës. Ky është një investim në shkallë të gjerë në energjinë e rinovueshme nga një institucion i arsimit të lartë në rajon. I dyti, ishte nënshkrimi i një memorandumit të bashkëpunimit me komunën e Tetovës për t'i ndihmuar ata në zhvillimin dhe zbatimin e Planveprimit klimatik - komunal.

Instituti është një institucion unik rajonal i përkushtuar për ruajtjen e përgjegjshme mjedisore dhe bashkëjetesës. Universiteti parashikon të luajë një rol gjithnjë në rritje në krijimin, formalizimin dhe implementimin e nismave mjedisore.

Universiteti ka vazhduar këtë vit të sigurojë shporta për riciklimin e letrës në të gjitha ndërtesat kryesore në kampus.

4.0 Sigurimi i cilësisë

Universiteti është pjesë e vlerësimit të dytë kombëtar për rangim të institucioneve të arsimit të lartë dhe për momentin është duke grumbulluar të dhëna në përputhje me kërkesat. Universiteti doli i dyti në rangimin e parë (nga nëntëmbëdhjetë institucionet e vlerësuara) dhe që atëherë, ka përdorur në mënyrë aktive kriteret dhe rezultatet për të zhvilluar cilësinë në fusha të tilla si rezultatet e hulumtimit, cilësia e të nxënësve dhe mësimdhënia dhe promovimin e stafit akademik.

Në aspektin e strukturave të rregullta të cilësisë, Bordi i Universitetit ka siguruar monitorimin e rregullt të planeve të universitetit dhe ka monitoruar implementimin e kontrollit të cilësisë së të dhënave të verifikueshme në fushat e menaxhimit të performancës, auditimit financiar të Universitetit dhe planifikimit, vlerësimit të stafit dhe procesit të punësimit, menaxhimit të performancës dhe zhvillimit akademik. Komiteti për çështje të stafit dhe Komiteti i auditimit dhe menaxhimit të rrezikut shpesh kanë mbikëqyruar grumbullimin dhe analizën e këtyre të dhënave.

Komiteti për çështje të stafit ka vënë në dukje disa ndryshime që janë bërë në Rregulloren për rangim, rroga dhe kompensime të tjera. Rregullorja për promovim në thirrje mësimore-shkencore është rishikuar për të përkrahur sistemin për ndarjen e pikëve dhe për të krijuar një sistem qendror të monitorimit për të forcuar cilësinë e procesit. Rregullorja për hulumtim është ndryshuar për ta bërë atë më efektive. Edhe Rregullorja dhe udhëzimet për

studime në ciklin e tretë janë duke u finalizuar për regjistrimet e reja në studimet e doktoraturës. Universiteti edhe një herë është vlerësuar nga jashtë për standardin e menaxhimit të performancës ISO 9001:2008. Gjithashtu, nga Raporti vjetor për punësim shihet se vendet e lira administrative janë plotësuar në bazë të një procesi strikt, të hapur dhe transparent.

Sistemi aktiv i vlerësimit (vlerësimi i stafit) për vitin e dytë radhazi është implementuar për të gjithë stafin, me trajnimin e përshtatshëm për vlerësuesit. Cilësia e raporteve është monitoruar nga Zyra e cilësisë dhe Zyra e burimeve njerëzore dhe është siguruar një raport i cili nxjerr në pah anët e forta dhe të dobëta, gjë që edhe çoi në trajnim. Në periudhën që mbulohet nga ky raport, Ekipi menaxherial i rektorit dhe çdo fakultet, qendër dhe departament administrativ kanë përpiluar planet e veprimtimit ku i definojnë aktivitetet e tyre profesionale për vitin e ardhshëm. Secili prej këtyre planeve u moderua dhe progresi është kontrolluar nga rektori apo provosti. Nga çdo njësi u kërkua që të konsultohen me stafin e vet për përgatitjen dhe zbatimin e planeve dhe shumica e kanë bërë këtë.

Çdo fakultet ka shqyrtuar programet e veta studimore në përputhje me kërkesat ligjore dhe këto janë akredituar me sukses nga Bordi i akreditimit dhe vlerësimit. Procesi i akreditimit të mentorëve të doktoraturës në përputhje me kërkesat kombëtare, ka rezultuar me pranimin e shumicës së aplikantëve për studime të doktoraturës.

Universiteti ka ofruar trajnim dhe zhvillim profesional nëpërmjet buxheteve të deleguara të departamenteve dhe Qendrës për zhvillim profesional (QZHP). Qendra për zhvillim profesional ka organizuar trajnime të rregullta, siç janë shkathtësitë gjuhësore, ose trajnime për vëzhguesit e ri. Përveç kësaj, QZHP ka organizuar dy programe të trajnimit për të gjithë stafin në janar dhe gusht, ku është bërë punë e mëtejshme për të nxënëit dhe mësimdhënien, vlerësimin dhe menaxhimin efektiv. Gjatë trajnimit në gusht, i gjithë stafi ka plotësuar anketën për të siguruar perceptimet e të gjitha njësive akademike dhe administrative, rezultatet janë ndarë dhe janë diskutuar nga menaxherët e njësive akademike dhe administrative.

Këshilli i rektorit ka ruajtur rolin e tij si një organ për diskutime, qarkullimin e informatave dhe këshillave, lidhur me çështjet akademike, ndërsa Kolegjiumi ka funksionuar në mënyrë efikase si forum menaxhimi për udhëheqësit e njësive administrative, i udhëhequr nga sekretari i përgjithshëm.

Politika e cilësisë është e lidhur drejtpërdrejt me Planin strategjik të Universitetit dhe Komisionin për sigurimin dhe menaxhimin e cilësisë, që ka siguruar një përshkrim të përgjithshëm dy herë në vit, për të përkuar me vizitat nga kampioni i jashtëm i cilësisë. Zyra e cilësisë ka operuar ose mbështetur proceset kyçe të cilësisë si: vëzhgimi i mësimdhënies, vlerësimi nga studentët dhe procedurat e menaxhimit të performancës, si dhe ka shërbyer si koordinator i veprimtarive operative. Zyra ka ofruar të dhëna kyçe dy herë në vit për analizë për fakultetet/departamentet. Zyra ka siguruar mbështetje për Parlamentin Studentor gjatë zgjedhjeve, përpilimit të rregulloreve, buxhetit dhe strukturës operacionale. "Kampioni i cilësisë" bëri dy vizita dhe ka ofruar raporte vlerësuese. Këtë vit u takua me një numër të madh të stafit të fakultetit për të dëgjuar mendimet e tyre. Ekipet e cilësisë ishin më funksional në departamentet administrative për shkak të punës së Kolegjiumit, por jo aq shumë funksional në fakultete.

Për të rritur dhe për të ruajtur cilësinë, është rekomanduar që Universiteti: të vazhdojë të maksimizojë përdorimin aktiv të proceseve të cilësisë dhe të monitorojë dhe të raportojë për efektivitetin e procedurave dhe rregullave të identifikuara; të zhvillojë iniciativa autonome të cilësisë në çdo njësi, me ekipe të forta të cilësisë dhe organeve publike të mirëbesimit, sidomos në fakultete; të vazhdojë të forcojë proceset e menaxhimit të performancës dhe personelit efektiv (për këtë, Universiteti duhet të shqyrtojë të gjitha përkrahjet e vendeve të punës dhe të merr në konsideratë baraspeshën e vëllimit të punës së stafit akademik në mes të mësimdhënies dhe hulumtimit për të inkorporuar mekanizma të shpërblimit për performancë të lartë); t'i rishikojë vizitat e kampionit të jashtëm të cilësisë dhe këto të bëhen në baza të rrotacionit me 'kampionë' të ndryshëm, duke ofruar një shumëllojshmëri të perspektivave; të nisë një cikël të rishikimeve të jashtme kurrikulare; të forcojë përdorimin e vendimmarrjes së evidentuar në të gjitha fushat dhe shpërndarjen efektive të tyre; të vazhdojë të forcojë përfshirjen e studentëve në sigurimin e kontributit aktiv në organet universitare dhe ta përmirësojë 'jetën studentore në kampus' përmes Parlamentit Studentor dhe mjeteve të tjera; dhe të mirëmbajë dhe përmirësojë efikasitetin e përgjigjes sonë ndaj studentëve dhe palëve të interesuara, si dhe pajtueshmërisë me standardet e shërbimit, duke përfshirë standardin e përgjithshëm të komunikimit.

5.0 Mësimdhënia dhe nxënia

5.1 Programet dhe statusi

Të gjitha fakultetet e UEJL-së kanë vazhduar të ofrojnë programe studimore të ciklit të parë dhe të dytë në vitin akademik 2012-2013; kjo do të ndryshojë në vitin akademik 2013-2014, kur do të fillojë Shkolla e doktoraturës dhe ku të pesë Fakultetet do të fillojnë të ofrojnë studime të ciklit të tretë.

Universiteti udhëhoqi me sukses tre programe *online* të ciklit të dytë, të cilat u menaxhuan me sukses nën mbikqyrjen e Fakulteteve përkatëse dhe Qendrës për studime në distancë (eLearning).

Interesi për programet e ciklit të dytë është rritur në mënyrë të konsiderueshme këtë vit dhe këto programe deridiplomike vazhdojnë të jenë pjesë e rëndësishme e ofertës akademike të Universitetit; disa programe të ciklit të dytë të studimeve në UEJL kanë pasur numër të studentëve të përafërt apo edhe mbi numrin e studentëve të regjistruar në studimet deridiplomike. Kjo është gjithashtu e rëndësishme për promovimin e Universitetit dhe rekrutimin e studentëve, pasi po gëzojmë dhe zhvillojmë një reputacion të shkëlqyer për ciklin e dytë në rajon, sidomos në Kosovë ku kemi pasur një rritje të madhe të numrit të kandidatëve për studimet e ciklit të dytë.

Universiteti gjithashtu ofron disa programe të studimeve me korrespondencë, ku pjesa më e madhe e mësimin zhvillohet nëpërmjet burimeve *online*, ndërsa studentët dhe mësimdhënësit në mënyrë individuale takohen (zakonisht) tre ose katër herë në semestër. Ky program është dëshmuar si mjaft tërheqës, sidomos për studentët që kanë obligime të ndryshme, si për shembull për kujdesje ndaj ndonjë anëtare të familjes, që është në

marrëdhënie pune me orar të plotë dhe detyrime tjera të cilat i pengojnë ata të ndjekin studimet e rregullta. Duhet të theksohet se aktualisht nuk ka rregulla ose udhëzime specifike lidhur me vlerësimet dhe studimet me korrespondencë, udhëzime këto të cilat mund të tregohen si mjaft të dobishme.


5.2 Regjistrimi i studentëve

Ashtu siç edhe ishte parashikuar, në vitin akademik 2012/2013, numri i studentëve të regjistruar shënon rënie. Vështirësitë financiare të vendit, disperzimi i universiteteve, fakulteteve dhe programeve, si dhe ndryshimet demografike të popullsisë (emigrimi dhe zvogëlimi i shkallës së lindjeve), identifikohen si disa nga arsyet për këtë rënie të numrit të studentëve.

Viti akademik	Numri i studentëve
2010/2011	1595
2011/2012	1280
2012/2013	1165
Gjithsej	4040

5.20 Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar sipas viteve akademike

Ndarja e studentëve sipas gjuhës së studimit të programit të zgjedhur është treguar në tabelën më poshtë. Siç mund të vërehet, ka pasur një rënie në programet studimore që ofrohen në gjuhën shqipe, si dhe një rritje të lehtë në programet studimore në gjuhën maqedonase. Duhet, gjithashtu të theksohet se programet studimore që ofrohen në gjuhën angleze, edhe pse ka një rënie të lehtë në krahasim me vitin e kaluar, kanë shënuar një rritje/një përqindje më të lartë se në vitin akademik 2010/2011. Ky është një sukses i mirë, pasi ofertat e programeve në gjuhën angleze janë një aset i çmuar i programit akademik të UEJL-së, dhe që ka një vlerësim shumë pozitiv edhe nga komuniteti lokal.



5.21 Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar (cikli i parë dhe i dytë)

Numri i përgjithshëm i regjistrimeve në tabelën 5.22, tregon një rënie në tre vitet e fundit. Siç mund të shihet, rënie më të madhe ka në Fakultetin e Administrimit Publik dhe Shkencave Politike, e ndjekur nga Fakulteti Juridik. Ndërsa, në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë dhe në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit vërehet një rritje e numrit të regjistrimeve.

Fakulteti	2010/2011	2011/2012	2012/2013
BE	364	273	290
SHTB	235	208	175
JURIDIK	320	274	206
GJKK	301	207	247
APSHP	375	318	247
Gjithsej	1595	1280	1165

5.22 Regjistrimet e përgjithshme sipas fakulteteve

5.3 Shkalla e kalueshmërisë së studentëve

Me kalueshmëri të studentëve nënkuptojmë progresin e studentit nga viti në vit në afatin e paraparë kohor ose thënë me fjalë tjera nëse studenti vazhdon të qëndrojë dhe vazhdojë studimet në programin e zgjedhur studimor. Natyrisht, rrethanat individuale apo tragjeditë eventuale mund të shkaktojnë ndërprerjen e studimeve të studentit. Megjithatë, në përgjithësi, pritet që një student i ciklit 3-vjeçar të studimeve deridiplomike në UEJL, të fitojë 180 kredi (ECTS), në kohëzgjatje prej 3 vjet, dhe të diplomojë në këtë periudhë të caktuar kohore.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur shkalla e kalueshmërisë për studentët e gjeneratës 2010/11 e cila në nivel të Universitetit arrin 67%. Në raportin paraprak vetëvlerësues kjo shkallë u identifikua si shkallë jo shumë e pranueshme.

Gjenerata 2010/2011	Studimet e rregullta Regjistrimet 2010/11	Kalueshmëria 2011/12		Kalueshmëria 2012/13	
		Fakulteti	Studentët	Kalueshmëria në vitin e dytë	%
BE	173	147	82,18%	107	64,37%
SHTB	165	132	74,23%	114	68,71%
JURIDIK	185	154	73,94%	119	68,09%
GJKK	199	157	78,14%	138	74,32%
APSHP	171	149	77,08%	128	70,31%
Gjithsej	893	739	82,75%	606	67,86%

Tabela 5.30 Shkalla e kalueshmërisë për gjeneratën 2010/11

Duhet të përmendim se stafi i Shërbimeve studentore, këshilltarët akademikë, dhe stafi akademik i Universitetit kanë dhënë një kontribut të madh për të mbajtur kalueshmërinë e studentëve. Në vitin akademik 2011/2012, shkalla trevjeçare e kalueshmërisë u përmirësua me rreth 10% dhe arriti në gjithsej 77% (në nivel të Universitetit). Ky është një rezultat mjaft domethënës, por megjithatë tregon se dy të pestat e studentëve tanë të vitit të parë nuk arrijnë kalueshmërinë deri në vitin e tyre përfundimtar. Kjo mbetet një sfidë e vazhdueshme, por duke parë përpjekjet dhe rezultatet e arritura mund të themi se progresi edhe mund të arrihet.


Gjenerata 2011/12	Studimet e rregullta Regjistrimet 2011/12	Kalueshmëria 2012/13		Kalueshmëria 2013/14	
		Fakulteti	Studentët	Kalueshmëria në vitin e dytë	%
BE	141	120	85,11%	111	78,72%
SHTB	142	114	80,28%	102	71,83%
JURIDIK	156	126	80,77%	124	79,49%

GJKK	101	84	83,17%	81	80,20%
APSHP	158	134	84,81%	123	77,85%
Gjithsej	698	578	82,81%	541	77,51%

Tabela 5.31 Kalueshmëria për gjeneratën 2011/12

5.4 Shkalla e diplomimit

Shkalla e diplomimit i referohet përfundimit të suksesshëm të programit studimor nga ana e studentit brenda kohës së parashikuar. Këto programe deridiplomike realizohen me 180 ECTS, me një kohëzgjatje të studimeve prej tre (3) vjet, përkatësisht gjashtë (VI) semestra (çdo semestër nga 30 ECTS). Nëse analizojmë përfundimin në kohë të studimeve sipas fakulteteve, atëherë do të vërejmë se në vend të parë është Fakulteti i GJKK, i pasuar nga Fakulteti i BE dhe SHTB. Fakulteti i Drejtësisë dhe APSHP kanë shkallën më të ulët të diplomimit në kohë.



5.40 Shkalla e diplomimit sipas fakulteteve për gjeneratën 2010/2011


5.5 Vlerësimi i stafit akademik nga studentët

Duke ndjekur praktikën e rregullt, edhe këtë vit u anketuan (në mënyrë anonime) studentët, qëllimi i së cilës është marrja e informatave rreth përshtypjeve, problemeve të studentëve dhe në përgjithësi sa ata janë të kënaqur me pedagogët, lëndët e tyre dhe përvojën e tyre të përgjithshme në Universitet.

Ky proces koordinohet nga një ekip i krijuar nga anëtarët e Zyrës për sigurimin e cilësisë, Shërbimi studentor, dhe këshilltarët studentor. Studentët e ciklit deridiplomik u anketuan në mars; ndërsa studentët e ciklit pasdiplomik në muajin maj. Sondazhi vetë administrohet

zakonisht në klasë nga këshilltari studentor, pa praninë e pedagogut në klasë. Kjo bëhet me qëllim që të fitohen përgjigje sa më të sinqerta, pa ndërhyrje ose ndikim të mundshëm nga ana e pedagogut të lëndës.

Tabela në vijim tregon rezultatet e anketimit/vlerësimit të stafit akademik nga studentët për vitin 2012/2013 dhe krahasimet sipas viteve :



5.50 Rezultatet nga raportet e vlerësimit të stafit akademik nga studentët

Siç mund të shihet, rezultatet e përgjithshme të vlerësimit janë pozitive. Këtë vit përsëri ka një rritje të lehtë sa i përket kënaqësisë së studentëve për fushat e vlerësuara. Këta janë tregues për vazhdimësinë e sigurimit të cilësisë dhe përgjegjshmërisë nga ana e stafit akademik. Në veçanti është inkurajues fakti që studentët e anketuar kanë vlerësuar si shumë pozitive dhe është arritur një shkallë e kënaqshme në kategoritë “aftësitë e mësimdhënies” dhe “vlerësimi”, pasi këto dy fusha paraqesin bazën e mësimin të hapur dhe produktiv. Dy fushat që kërkojnë përmirësim, bazuar në këto rezultate, janë shfrytëzimi i sistemit të menaxhimit të të mësuarit, dhe interaktiviteti në klasë.


Rezultatet nga vlerësimi i studentëve për stafin akademik janë proceduar nga Shërbimi studentor në mënyrë konfidenciale, dhe raportet individuale më tej u dërguan nga Zyra për sigurimin e cilësisë deri tek anëtarët e stafit dhe tek ekipi ekzekutiv i rektorit, Zyrën e burimeve njerëzore, dhe dekanët ose drejtorët gjegjësisht. Dekanët ose drejtorët më tej kanë përdorur këto raporte në takimet e vlerësimeve (vlerësimet vjetore të stafit) atshme ose të Drejtorëve. Dekanët ose Drejtorët pastaj përdorur këto raporte në takimet e tyre të vlerësimit (Vlerësimet të stafit) me stafin akademik.

5.6 Qendra e karrierës

Qendra e karrierës në UEJL është urë lidhëse në mes të studentëve të universitetit tonë dhe kompanive/punëdhënësve në vend. Qendra ofron këshillime dhe u ndihmon studentëve në disa fusha si për shembull: të shkruarit e CV-së, letrës së motivimit, teknikave të intervistës për punë, dhe këshilla të tjera praktike të nevojshme për të gjetur punë. Qendra gjithashtu ndihmon dhe menaxhon punën praktike të studentëve (internship) dhe kërkesat për trajnim praktik.

Në vitin 2012-2013, Qendra e karrierës realizoi me sukses pesë aktivitete mjaft të rëndësishme për Universitetin. Siç u përmend edhe më parë, mbikëqyri procesin e kryerjes së mësimit praktik; u mundësoi studentëve krijimin e lidhjeve me tregun e punës; organizoi Panairin e karrierës (e cila krijoi hapësirë për ndërveprim në mes të studentëve dhe 40 kompanive dhe organizatave joqeveritare që morën pjesë në këtë Panair); organizoi trajnime me nxënësit e shkollave të mesme lokale; priti një delegacion nga Shqipëria që erdhën me qëllim të marrjes së përvojës lidhur me themelimin dhe funksionimin e Qendrës së karrierës nëpër universitetet e tyre.

Qendra e karrierës gjithashtu ndjek vazhdimisht dhe i analizon të dhënat rreth punësimit të të diplomuarve të UEJL. Çdo vit, Qendra realizon anketën destinimi i Alumni-t të UEJL (*SEEU Alumni Destination*), që ka për qëllim vlerësimin e tendencave dhe sfidave të punësimit të të diplomuarve të UEJL. Sipas të dhënave të fituara nga ky studim, studentët e UEJL-së vazhdojnë të jenë të punësuar në një normë më të lartë së mesatarja e vendit.



Shkalla e përgjithshme e punësimit të të diplomuarve të UEJL

Shkalla e përgjithshme e punësimit të të diplomuarve të UEJL-së të vitit 2012 është 52,61% ndërsa shkalla e papunësisë është 47,39%. Sa i përket punësimit, 90,06% e tyre janë të punësuar me orar të plotë pune, 4,51% janë të punësuar me orar të pjesshëm, 2,71% e tyre janë të vetë-punësuar (kanë biznesin e tyre), dhe 2,71% janë duke bërë punë praktike. Nga numri i përgjithshëm i të diplomuarve që kanë ngelur të papunë, 29,76% kanë treguar se janë të papunë me zgjedhjen e tyre, kështu që shkalla aktuale e papunësisë së të diplomuarve të UEJL-së është vlerësuar rreth 17,63% .

Sa i përket punësimit bazuar në notën mesatare, sipas të dhënave të fituara kemi konstatuar se shkalla e punësimit të të diplomuarve me notë mesatare mes 6 dhe 7 është 52,51%, ndërsa tek ata me notë mesatare mes 9 dhe 10 është 45%. Është për tu shqetësuar fakti se suksesi akademik nuk luan ndonjë rol të madh sa i përket punësimit të të diplomuarve.

Lidhur me kohën kur të diplomuarit e Universitetit tonë punësohen, është konstatuar se 46,08% e tyre arrijnë të gjejnë punë para diplomimit të tyre, 13,55% punësohen diku rreth 1-3 muaj pas diplomimit, 9,93% gjejnë punë në një periudhë prej 4-6 muaj pas diplomimit dhe 13,55% në një periudhë 10-12 muaj pas diplomimit. Pjesa tjetër e mbetur kanë arritur të punësohen pas më shumë se një viti pas diplomimit të tyre.

5.7 Asociacioni i Alumni-t

Asociacioni Alumni i UEJL-së është një organ që ka për qëllim të mbajë lidhjet dhe komunikimin në mes të gjithë të diplomuarve dhe stafit akademik dhe administrativ të UEJL; të ofrojë mundësi për takime të vazhdueshme të të diplomuarve duke mbajtur dhe zhvilluar kontaktet shoqërore dhe profesionale me njëri-tjetrin; të vazhdojë të kontribuojë dhe përkrahë UEJL; të japë ide dhe sugjerime për përmirësim të Universitetit; dhe të promovojë Universitetin duke demonstruar angazhimin dhe përkujdesjen tonë të vazhdueshme për studentët tanë edhe pas diplomimit të tyre.

Një arritje e madhe e Asociacionit Alumni këtë vit ishte takimi që u realizua mes menaxhmentit të lartë dhe Alumni (të diplomuarve) që jetojnë në Kosovë, i cili u mbajt më 13 qershor 2013 në Prishtinë. Ky takim u mbajt për herë të dytë ku një numër i madh i të diplomuarve të UEJL në Kosovë patën mundësinë të ri-takohen së bashku dhe të shkëmbejnë perspektivat dhe përvojat e tyre.

Edhe pse Asociacioni Alumni ka një përkrahje të madhe, Universiteti duhet të përcaktojë qartë rolet dhe përgjegjësitë e këtij Asociacioni, pasi ekziston një paqartësi se çfarë autonomie dhe përgjegjësie ka ndaj Universitetit ky Asociacion. Ky sqarim do të ndihmojë në promovimin më të madh të Asociacionit dhe do të ndihmojë në përfshirjen e një numri më të madh të vullnetarëve dhe kontribuesve nëpër takimet dhe ngjarjet e ndryshme të Alumni-t.

6.0 Hulumtimi

Zyra e hulumtimit, e përbërë nga Prorektori për punë kërkimore dhe marrëdhënie ndërkombëtare dhe dy koordinatorët e kësaj zyre, është organi kryesor për veprimtaritë hulumtuuese kërkimore në Universitet. Ata vazhdimisht janë duke kërkuar programe dhe partnerë në nivel ndërkombëtar, duke ju ofruar në të njëjtën kohë ndihmë individuale stafit akademik të Universitetit.

Ndër aktivitetet kryesore të Zyrës për hulumtim në vitin akademik 2012/2013 ishte themelimi dhe funksionimi i Institutit për hulumtime "Max Van der Stoel". Ky Institut ka për qëllim të udhëheqë veprimtaritë kërkimore-shkencore në Universitet, si dhe strategjitë e hulumtimit nga fusha e drejtësisë, shkencat politike, të drejtat e njeriut, dhe diplomacisë. Këto kompetenca e ndihmojnë Institutin që të aplikojë për projekte të ndryshme ndërkombëtare, si dhe të propozojë dhe krijojë partneritet me universitete të dalluara, me institute të ndryshme hulumtuuese, ose OJQ.

Instituti "Max Van der Stoel", në pjesën më të madhe të viti, u angazhua për të krijuar një projekt që ndërlidhet me temat aktuale të Maqedonisë, BE dhe NATO. Ky projekt, i titulluar "Integrimi Euro-Atlantik", ka për qëllim të vlerësojë rolet, përgjegjësitë dhe perspektivat me

të cilat ballafaqohet Republika e Maqedonisë gjatë përpjekjeve të saja për të hyrë në NATO dhe në familjen e Bashkimit Evropian. Këto janë çështje që tangojnë edhe vetë shtetin, por kanë gjithashtu pasoja për vendet tjera të cilat përpiqen që të modernizohen dhe të integrohen në organet më të mëdha ndërkombëtare.

Instituti "Max Van der Stoel" në bashkëpunim me Universitetin e Kolumbisë (Instituti për të drejtat e njeriut) realizuan trajnimin e mësimitdhënësve për zgjidhjen e konflikteve dhe harmoninë sociale. Ky trajnim, që u mbajt në mars të 2013, mundësoi përfitime të drejtpërdrejta për pjesëmarrësit e trajnimit, dhe përfitime indirekte për njerëzit tjerë që do të trajnojnë këta pjesëmarrës në të ardhmen.

UEJL vazhdoi bashkëpunimin me Universitetin e Kolumbisë edhe sa i përket një studimi (që është në vazhdim e sipër) të Implementimit të marrëveshjes së Ohrit (OFA). Ky projekt trevjeçar, i mbështetur financiarisht nga qeveria e Maqedonisë, bën analizë vjetore të Marrëveshjes së Ohrit, sukseset dhe dështimet e saj. UEJL është koordinatori vendor i këtij projekti në Maqedoni.

Zyra për hulumtime nuk merret vetëm me projektet e mëdha ndërkombëtare hulumtuese. Ajo i ofron mbështetje dhe këshillime stafit akademik të Universitetit për realizimin e veprimtarive të tyre kërkimore shkencore, njofton për konferenca të ndryshme shkencore, ofron ndihmë për aplikime për grante dhe verifikon legjitimitetin e revistave shkencore akademike. Përveç kësaj, Zyra për hulumtime ofron edhe ndihmë materiale për stafin duke mbuluar një pjesë të shpenzimeve të tyre të udhëtimit nëpër konferenca akademike shkencore; gjatë vitit akademik 2012/2013, gjithsej 63 hulumtues individualë u përkrahën të marrin pjesë nëpër konferenca dhe 10 punime u pranuan për t'u botuar në revista ndërkombëtare të listuara në Thomson Reuters Web of Science.

Një iniciativë tjetër që ndërmori Zyra për hulumtime është modernizimi dhe azhurnimi i bazës së të dhënave të hulumtimit. Në këtë bazë të të dhënave evidentohen në formë elektronike pjesëmarrja e stafit nëpër konferenca, historia e publikimeve, dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për veprimtaritë kërkimore shkencore. Ky ri-freskim i sistemit e racionalizoi dhe e qartësoi procesin e evidentimit të hulumtimit, dhe i ndihmoi menaxherët në vlerësimin e punës së stafit të tyre. Nga viti akademik 2013-2014 kjo bazë e të dhënave do të ndërlidhet drejtpërdrejt me proceset promovuese të zgjedhjes dhe ri-zgjedhjes në titujt akademik.

Edhe pse të gjitha këto aktivitete kontribuojnë në përmirësimin e portfolios hulumtuese në UEJL, përsëri ka edhe shumë punë për tu bërë. Të ardhurat nga projektet hulumtuese janë akoma të ulëta në krahasim me ambiciet e arsyeshme të UEJL. Në të ardhmen, një ndër qëllimet kryesore është të rrisim veprimtaritë hulumtuese, të aplikojmë dhe të fitojmë projekte më të mëdha hulumtuese ndërkombëtare. Struktura e re e Institutit "Max Van der Stoel" është planifikuar me buxhet këtë vit, dhe pritet angazhim i grupeve hulumtuese, në veçanti me Fakultetin e biznesit dhe ekonomisë.

6.1 Marrëdhëniet ndërkombëtare

Zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare punon në promovimin e mundësive ndërkombëtare për bashkëpunim në UEJL. Pasi Universiteti është ndërkombëtar në pikëpamje strukturore, Zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare po bën përpjekje të vazhdueshme të gjejë mundësi për stafin dhe studentët tonë për të udhëtuar jashtë vendit si dhe për të na vizituar studentë dhe profesorë të jashtëm.

Viti 2012-2013 nuk ishte edhe aq pozitiv sa i takon lëvizshmërisë së studentëve. Edhe pse fituam 34 mundësi nga Erasmus, vetëm 3 studentë dhe 1 anëtar i stafit pranuan lëvizshmërinë. Kjo ndoshta ngaqë shumica e përkrahjes ishte 350€ në muaj, pavarësisht nga destinacioni. Shpresojmë se vitin e ardhshëm, kur bursat ndryshojnë varësisht nga harxhimet e jetesës të vendit të destinacionit, do të rritet edhe numri i stafit dhe studentëve të UEJL të cilët do të punojnë dhe studiojnë jashtë vendit.

Universiteti përfitoi nga dy grante të Basileus-it; një student i studimeve deridiplomike mori përkrahje për të ndjekur një vit studimi në Universitetin e Lubjanës, dhe një anëtar i stafit administrativ mori përkrahje të plotë për të ndjekur studimet e tij të doktoraturës në Sofje.

Universiteti nënshkroi edhe 7 marrëveshje bilaterale me institucione partnere jashtë vendit duke rritur kështu numrin në 12. Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare vazhdon të kërkojë mundësi të reja bashkëpunimi me këta partnerë, dhe të kërkojë partneritete të reja dhe mundësi udhëtimi për stafin dhe studentët tonë.

7.0 Ndërmarrësia dhe Zhvillimi

Universiteti i Evropës Juglindore ndjek dy rrjedha kryesore të ndërmarrësisë dhe zhvillimit: e para mësime dhe bazuar në hulumtime dhe tjetra është depërtimi në jetën ekonomike dhe sociale të komunitetit. Kur hyn në botën e biznesit praktik, Universiteti duhet të ndjekë standardet më të larta të ekspertizës dhe njohurive. Kjo qasje do të mundësojë Universitetit që në mënyrë të pavarur për zhvillojë planet dhe programet e veta akademike. Objektivi përfundimtar do të jetë rritja e fleksibilitetit dhe zbatueshmëria ofertës së Universitetit, për të ndihmuar sektorin privat në përpjekjet e tyre për të ecur bashkë me pjesën tjetër të botës së zhvilluar të biznesit. Një orientim i tillë, eventualisht mund të bëhet burim i rëndësishëm të ardhurave në kohën e duhur.

Aktivitetet sipërmarrëse të Universitetit janë të parapara në planet strategjike. Në fillim, të ardhurat nga aktivitetet sipërmarrëse kryesisht janë menduar për të siguruar mbështetje financiare për prioritetet e mësimeve, por këto aktivitete duhet të zhvillohen për të ofruar një burim të rëndësishëm të të ardhurave. Universiteti ka nevojë, që si objektivi afatgjatë sipërmarrës, të zhvillojë shkathtësitë, aftësitë dhe kapacitetet për të përmbushur nevojat e sektorit privat. Kjo do të ndihmojë Universitetin të jetë më pak i varur nga luhatjet në numrin e regjistrimeve, ose nga ndryshimet e politikave qeveritare për arsimin e lartë.

Qendra për Zhvillimin e Biznesit është lidhja primare sipërmarrëse me komunitetin. QZHB tërheq klientët dhe partnerët potencialë nga mjedisi lokal dhe më i gjerë shoqëror, duke krijuar një rrjet të rëndësishme të palëve të interesuara me Universitetin. Disa seminare janë realizuar për punonjësit e kompanive të ndryshme (Adria Sport, Molika, Veze Sharri, Frigotehnika 2000, Moding, Festa Commerce, Hildin Commerce, Sharr Planina, Ambasada e

SHBA-ve, Universiteti Ilyria nga Kosova, ProCredit Bank, etj.). QZHB ka marrë pjesë në definimin e programeve të reja të studimeve të integruara dhe ka pasur rol të rëndësishëm në nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit në mes Universitetit dhe Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore. QZHB ka kontribuar ndjeshëm në logjistikën e projektit të "Shkollës Verore të Doktoraturës", projekt i organizuar nga Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore dhe Bibliotekës Ekonomike Kombëtare Gjermane.

Në pranverën e vitit 2013 u hap edhe Parku Teknologjik në UEJL-Tetovë. Ka katër kompani aktive që punojnë në Parkun e Teknologjik, qëllimi dhe aktivitetet e tyre vazhdimisht rriten duke krijuar më shumë vende pune, si edhe ndërtimin e lidhjeve më të gjëra në mes UEJL-së dhe komunitetit të biznesit.

8.0 Financimi

Universiteti vazhdon të jetë plotësisht i vetëfinancuar, pa asnjë financim nga buxheti shtetëror edhe përkundër faktit se si institucion kontribuon në prodhimin e të mirave me natyrë publike. Proporcioni i të ardhurave për vitin akademik 2012/13 ishte si vijon: afërsisht 90% e të ardhurave janë nga pagesat e shkollimit, deri në 5% të ardhura tjera (të hyra nga aktivitetet komerciale, interesi nga depozitat dhe investimet në tregun e kapitalit, etj) dhe afërsisht deri në 5% nga projekte dhe donacione.

Sa i përket menaxhimit financiar, kanë vazhduar përpjekjet për të arritur përcaktimet strategjike të Universitetit për rruajtjen e qëndrueshmërisë financiare përmes konsolidimit të burimeve të qëndrueshme të financimit dhe eksplorimit të formave të tjera të financimit dhe diversifikimit të burimeve financiare.

Projeksionet e të ardhurave dhe shpenzimeve të Universitetit planifikohen sipas Kornizës afatmesme buxhetore. Kjo kornizë afatmesme buxhetore 3-vjeçare e shpenzimeve siguron konsistencë të niveleve të shpenzimeve të Universitetit brenda kufizimeve të burimeve të përgjithshme, në mënyrë për të siguruar stabilitetin financiar dhe për të maksimizuar efikasitetin e shpenzimeve të përgjithshme.

Universiteti vazhdon me zbatimin më konsekuent të kritereve të efikasitetit në shpërndarjen e burimeve financiare, në bazë të llogaridhënies ekonomike, financiare dhe të arsyeshmërisë. Në këtë drejtim janë bërë përpjekje në ngritjen e kapaciteteve në nivel institucional dhe të njësive akademike dhe administrative, në mënyrë që të krijoj optimizimin dhe racionalizimin e kostove që do të rezultojë në shpërndarjen e burimeve efikase dhe tashmë çdo njësi operohet mbi bazën e arsyes ekonomike dhe financiare sipas strukturës së bazuar në Treguesit e performancës kyçe.

Zhvillimi i vazhdueshëm i Enterprise Resource Planning (ERP) ka vazhduar të jetë ndër prioritetet kryesore të menaxhimit financiar dhe me qëllim të sigurimit të shërbimeve më cilësore financiare, respektim të dispozitave ligjore dhe me qëllim të operimit më efektiv përveç përditësimit të vazhdueshëm të procedurave janë krijuar edhe standardet e shërbimit të financave.

Pasi qëndrueshmëria financiare e Universitetit është një nga brengat kryesore të Senatit të Universitetit dhe stafit, është sugjeruar ristrukturimi i departamentit të financave (rekomandim gjithashtu i auditit të jashtëm); procesi i rekrutimit të drejtorit të financave dhe rishikimi i strukturës së departamentit janë në proces.

9.0 Mjedisi në kampus dhe shërbimet

9.1 Përkrahja e studentëve

Përkrahja e studentëve kryesisht është realizuar nëpërmjet Shërbimeve Studentore dhe Zyrës për ndihmë financiare. Studentët për vitin akademik 2012/2013 janë përkrahur financiarisht nëpërmjet programit të bursave të universitet, grantet e donatorëve të bursave, programi *“Punë dhe studime”*, si dhe programin financiar-zbritje për studentin e dytë dhe të tretë të familjes në total rreth 21.5% të studentëve të rregullt në studimet deridiplomike financiarisht janë përkrahur.

Programi i bursave përbërët nga dy grupe: bursat meritore të universitetit në bazë të rezultateve të treguara nga vlerësimi paraprak i diturive dhe bursat në bazë të nevojës financiare, në bashkëpunim me Fondacionin për Shoqëri e Hapur. Në nivel të Universitetit 267 bursa janë dhënë, d.m.th 147 bursa meritore dhe 120 në bazë të nevojës financiare, që do të thotë se rreth 11.5% e numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt janë përkrahur me bursa që mbulojnë mbi 75% të tarifës së shkollimit të në programin e studimit përkatës.

Nga pikëpamja financiare, rreth 5% e studentëve të rregullt janë përkrahur nëpërmjet programit *“Punë dhe studime”*. Përmes këtij programi, studentët u angazhuan në shërbimet e ndryshme të universitetit duke përfituar nga përvoja relevante nga edhe realizojnë mjete financiare për të mbuluar një pjesë të tarifës së shkollimit të tyre. Në këtë vit akademik, 115 studentë ishin të angazhuar në këtë program.

Gjithashtu, në mbështetje të familjeve që kanë më shumë se një student që studion në UEJL është bërë zbritje të pagesës së shkollimit për studentin e dytë ose të tretë nga e njëjta familje. Nëpërmjet këtij programi të Universitetit ka mbështetur 136 studentë, çka përfaqëson 5.5% të numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt.

Vëmendje e veçantë i është dhënë zhvillimit të qasjes efektive për studentët me nevoja të veçanta dhe mundësitë për bursa për këtë grup të studentëve.

Në vitin e ri akademik, Universiteti në bashkëpunim me sektorin bankar ka paraparë të ofrojë një skemë të kredive studentore. Kjo do të shërbejë si një instrument shtesë për mbështetjen e studentëve dhe do të ndihmojë të mbajë lidhje të forta me kompanitë që duan të përkrahin studentët e UEJL-së me bursa.

9.2 Ngrehinat dhe kapacitet teknike

Hapësirat e Universitetit dhe pajisjet përcjellëse të tyre gjithmonë paraqesin një ambient të pastër, të këndshëm, atraktiv dhe të sigurt për studentët, stafin dhe vizitorët. Këtë fakt e

fuqizojnë edhe më tepër vlerësimet on line të bëra nga studentët dhe stafi, ku regjistrohen rezultatet të larta dhe mbahen stabile rezultatet e larta. Ky është fryt i angazhimit i të gjithë të punësuarve në Universitet, por me një përkushtim të veçantë nga departamenti i mirëmbajtjes.

Në vazhden e përpjekjeve për të të përmirësuar performancën e matur me efikasitetin dhe efektivitetin e departamentit në lëmin e mirëmbajtjes dhe logjistikës në kampus kanë filluar të jetësohen gjithnjë e më shumë tre standardet e dizajnuara kohë më parë. Ristrukturimi vertikal në sistemin e menaxhimit të departamentit të mirëmbajtjes është treguar shumë funksional në ekonomizimin me resurse. Këtë vit, edhe pse ekziston evidenca për harxhimet në departamentin e financave, me sukses janë evidentuar të gjitha harxhimet që bëhen në këtë departament dhe duke i analizuar ata janë bërë përpjekje që të kursehen sa më shumë resurse. Është më rëndësi për këtë rast të përmendet kursimi i naftës që ka arritur deri në 30 ton.

Stafi i Departamentit për mirëmbajtje dhe logjistikë është i përfshirë në mënyrë shumë aktive në zbatimin e procedurave të bazuara në standardet ISO si dhe në procesin e zhvillimit për të përmirësuar cilësinë. Aplikimi i parimeve nga ky standard ndihmon me të madhe që të ngrihet cilësia duke caktuar në mënyrë sa më të saktë përgjegjësit dhe autorizimet.

Në kuadër të mirëmbajtjes së planifikuar, gjatë periudhës së verës janë bërë shumë riparime nëpër objekte që ata mbahen në kondicion. Vetë pamja e jashtme të jep përshtypje se mirëmbajtja është e nivelit të lart dhe me një planifikim preciz. Në pamjen e jashtme vlen të përmendet aplikimi i një sistemi të ri të navigacionit (shenja të reja) i cili shumë ju ndihmon vizitorëve se si të gjenden në kampus. Edhe koncepti për mirëmbajtje e mbeturinave është përmirësuar dhe janë reduktuar pikat për vendosjen e kontejnerëve që e ka përmirësuar pamjen, për studentët dhe vizitorët.

Mjedisi i ri i Qendrës së UEJL-së në Shkup është rimodelim si i porositur nga një qendër tregtare në të kaluarën në një mjedis të pastër akademik. Ka një vendndodhje qendrore dhe pamje tërheqëse. Universiteti ka shpresa të larta se ky vend i ri i UEJL-Shkup do të ofrojë për studentët tanë kushte të shkëlqyera për të studiuar dhe do të ndihmojnë në rekrutimin e brezave të rinj të studentëve të UEJL-së.

Në vitin e ardhshëm akademik, një proces i vlerësimit të të inventarizimit do të ndërmerret, për të siguruar optimizmin e kostos në lëmi të ndryshme. Harta e infrastrukturës edhe mëtej duhet të përmirësohet.

9.3 Qendra e UEJL-së në Shkup

Viti akademik 2012-2013 ishte viti i pestë i funksionimit të Qendrës së UEJL-së Shkup. Pavarësisht konkurrencës së ashpër nga universitetet publike dhe private në kryeqytet, numrat e regjistrimeve kanë vazhduar të jenë të mirë. Qëllimi kryesor i Qendrës së Shkupit është që të ofrojë programe arsimore të njëjtës cilësi me ata që ofrohen në kampusin kryesor Tetovë.

Qendra e UEJL-së gjatë kësaj periudhe që mbulohet nga ky raport ka funksionuar në vendndodhjen tradicionale pranë Ambasadës Italiane. Pajisjet e brendshme dhe infrastruktura (projektuesit, kompjuterët, dërrasat, teknologjitë për video telekonferencë, sistemet e mbrojtjes, etj) ishin të kualitetit të lartë dhe ishin të ruajtura mirë. Megjithatë, siç u përmend në raportin paraprak të vetë-vlerësimit, madhësia dhe struktura e kësaj ndërtese vazhduan të pengojnë zhvillimin e programeve të reja. Për këtë arsye, u vendos që të kërkohet një vend i ri për Qendrën e UEJL-së Shkup, si dhe ndërtesa MOST u zgjodh dhe u rinovua për përdorim akademik.

Qendra e Shkupit ishte lokacioni ku u mbajt trajnimi CELTA gjatë muajit qershor 2013.

Rritja në hapësirë dhe lokacioni i ri i UEJL-Shkup është një zhvillim i një rëndësie të madhe institucionale për Universitetin, pasi tani ka mundësinë për të zgjeruar ofertën, konkurroj direkt me universitetet më të mira në kryeqytet dhe të rekrutoj studentë të rinj me vendndodhjen dhe strukturën e re.

9.4 Burimet njerëzore

Konform politikave të Bordit për zhvillimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e performancës si dhe ofrimin e mundësive të barabarta, Universiteti ka vazhduar me ndërtimin dhe perfeksionimin e sistemit në lëmin e burimeve njerëzore për të përkrahur zhvillimin e mëtutjeshëm të stafit. Janë rishikuar ose plotësuar rregulloret dhe procedurat adekuate si Procedura për rekrutim, Procedura për evalvim të stafit dhe rekrutimin e stafit u mbështetur plotësisht në kriterin e meritës.

Edhe këtë vit Universiteti ka shënuar përparim të burimeve njerëzore. Në pajtim me Ligjin dhe rregulloret e Universitetit janë avancuar – zgjedhur në thirrje mësimore shkencore një numër i konsiderueshëm i stafit akademik edhe atë dy profesorë ordinar, tre profesorë inordinarë, dymbëdhjetë docentë, një profesor inordinar i titulluar dhe katër docente të titulluar. Në thirrje të bashkëpunëtorëve janë zgjedhur 6 asistentë doktorantë. Në tabelën në vazhdim, janë prezantuar të dhënat për numrin e stafit akademik me orar të plotë pune sipas titullit shkencor gjatë tre viteve të fundit. Nga të dhënat shihet qartë se numri i stafit akademik me titull shkencor doktor ka trend rritës që korrespondon me synimet dhe përpjekjet e Universitetit që të rritur numrin e stafit me doktoratura (në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë).

Stafi F-T me tituj shkencor (2011, 2012 dhe 2013)

Titulli shkencor	Viti akademik		
	2010/2011	2011/2012	2012/2013
PhD	66	72	86
MA	72	64	52

BA	11	4	1
----	----	---	---

Këtë vit Universiteti ka trajtuar edhe çështjen e produktivitetit të administratës. Për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin janë zhvilluar monitorime për çdo pozitë gjatë disa javëve. Kjo ka rezultuar në optimizimin e resurseve nëpër departamente duke përmirësuar efikasitetin dhe zvogëluar koston. Këtë e tregon edhe tabela në vijim ku numri i stafit administrativ paraqitet i zvogëluar. Këto janë pozita të cilat Universiteti i ka optimizuar (detyrat e stafit që për arsye të ndryshme është larguar nga puna u janë ndarë stafit ekzistues që ka pasur vëllim të reduktuar të detyrave). Moment tjetër që ka ndikuar në përmirësimin e efikasitetit është edhe implementimi i evidentimit për hyrje-daljet e stafit administrativ gjë që ka rezultuar me mungesa dukshëm më të reduktuara në orar të punës.

Në vazhdim tabela me të dhënat (kualifikimin) për stafin administrativ gjatë tre viteve të fundit Stafi administrativ F-T (2011, 2012, 2013)

Titulli shkencor	Viti akademik		
	2010/2011	2011/2012	2012/2013
PhD	7	5	5
MA	19	15	15
BA	70	75	73
Të tjerë Other	33	34	32
Total	129	129	125

9.5 Sistemet e informacionit

Duke qenë të përkushtuar drejt arritjes së qëllimeve tona të përcaktuara për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve informacionit, me sukses kemi vazhduar zhvillimin dhe avancimin e mëtejshëm të infrastrukturës ekzistuese të sistemeve të informacionit.

Në pjesën e sistemit *Enterprise Resource Planning* (ERP) kemi arritur të përshtatim modulën për Zyrën e burimeve njerëzore. Kemi realizuar ndërlidhjen e modulit të ERP për burimet njerëzore dhe kornizës MIQ (Menaxhimi i Identiteti dhe Qasja- "*IAM framework Identity Management and Access*"), automatikisht të krijojë kredencialet e stafit me qëllim që lehtëson menaxhimin e identiteteve elektronike.

Në mënyrë që më tej të përmirësojmë sistemin e raportimit, si pjesë e sistemit ERP të Universitetit me sukses kemi ngarkuar bazat e të dhënave të ekzistuese në *Universities Enterprise Data Warehouse* dhe aty kemi organizuar kube shumëdimensionale për të krijuar raporte reale për analizën e të dhënave të cilat janë shumë të rëndësishme në vendimmarrje për menaxhmentin e Universitetit.

Arritje shumë të rëndësishme janë arritur gjithashtu në përmirësimet e realizuara në UMS. Për të gjeneruar raporte më të shpejta dhe të sakta për notën mesatare (GPA) dhe transkripteve për studentët, ne kemi zbatuar mekanizimin e kapjes dhe ridizajnuar skemen transkriptave modelin e studimit 3+ 1. Gjithashtu, sistemi UMS u pasurua me më shumë mjete dhe funksione në mënyrë që të plotësojnë kërkesat specifike (kërkuar nga palët e interesuara të ndryshme) si kritereve të reja për filtrimin e të dhënave të studentëve në mënyrë që të gjenerojnë të dhëna të nevojshme si për Ministrinë e Arsimit, Entin Shtetëror Statistikor, dhe Universitetin.

Në mënyrë që të bëjmë portalin MySEEU më intuitivë kemi zhvilluar GUI-in e ri, i cili është projektuar për t'u përdorur me ekrane dhe rezolucione të ndryshme (si me desktop, tableta dhe telefonat e mençur). Gjithashtu, kemi shtuar ndihmën kontekstuale të cilat çojnë në përvojë krejtësisht të re, kur përdoret portali MySEEU. Ne gjithashtu kemi arritur të zgjerojmë Modulin e prezencës në klasë (Class Attendance Module), kështu që tani edhe studentët mund të regjistrojnë prezencën e tyre në klasë në pajisjet RFID (lexuesit elektronik të kartelave të vendosura nëpër klasa). Një modul tjetër i integruar në MySEEU, siç kërkohet nga Komisioni Qendror për Hulumtime është Baza e të dhënave për hulumtimin (e njohur si ASPES).

Këto përmirësime të realizuara nga Departamenti TI kanë dëshmuar përkushtimin e Universitetit tonë që të vazhdojnë të jetë në mesin e udhëheqësve në implementimin e teknologjisë më të fundit nga fusha TI

9.6 Shërbimet e bibliotekës

Biblioteka e UEJL-së ofron shërbime bibliotekare për të dy kampuset në Tetovë dhe Shkup. Biblioteka kryesore në kampusin e Tetovës ka koleksionin primarë të librave dhe mbikëqyr drejtpërdrejtë degët e bibliotekës në disa fakultete, si edhe bibliotekën e Qendrës së UEJL-së në Shkup. Anëtarët e stafit të bibliotekës me orar të plotë gjithmonë janë të pranishëm, gjatë orarit, dhe ndihmojnë qarkullimin, të sigurojnë ndihmë për referencën, ofrojnë mbrojtje të burimeve, bëjnë katalogjizimin e blerjeve të reja, kthejnë në raftë huazimet dhe udhëzojnë gjatë punës studentët nga programi punë dhe studime. Ekziston gjithashtu koordinimi i ngushtë midis bibliotekës kryesore në Tetovë dhe bibliotekës në Shkup për të ofruar shërbim efikas për librat që janë të nevojshëm në Shkup, që mund të gjenden në bibliotekën e Tetovës.

Stafi i bibliotekës kanë ofruar gjithashtu trajnim si pjesë e programit orientues për studentët e vitit të parë në Universitet, si dhe trajnim në përdorimin e EBSCOhost database. Kostoja e anëtarësimit në bazën e të dhënave mbetet një shqetësim për stafin e bibliotekës; edhe pse mësimdhënësit dhe studentët gjithashtu do të përfitonin nga qasja në rrjetet online që janë dispozicion, kostoja e anëtarësimit të tillë shpesh është shumë e lartë.

Qëllimi i bibliotekës është që këtë vit të ndërmerr një vlerësim serioz të koleksionit, për të identifikuar materialet e vjetruara ose të papërdorura, dhe të siguroj burime të reja që janë më afër me ofertat aktuale akademike të Universitetit.

9.7 Parlamenti i studentëve

Në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë, Unioni i Studentëve formalisht u riformatua me Statutin e ri si Parlamenti Studentor. Parlamenti Studentor u konsolidua pas zgjedhjeve në nëntor dhe përfaqësuesit e ri bënë betimin.

Këta përfaqësues kanë marrë pjesë në Parlamentin e tyre, Senatin e Universitetit, mbledhjet e këshillit të fakultetit dhe kanë ofruar mbështetje të përgjithshme për studentët. Parlamenti këtë vit gjithashtu u zhvendos në një lokacion të ri në kampusin në Tetovë. Ata mbeten organi kryesor për organizimin e ngjarjeve studentore, "Eurotrip-it", ndihmë dhe udhëzim për studentët dhe përfaqësim të studentëve në organet qeverisëse të Universitetit.

9.8 Sporti dhe rekreacioni

Në mënyrë për të promovuar aktivitet sportive në Universitetin, Departamenti i Sportit (një njësi e pavarur brenda UEJL-së), këtë vit zhvilloi një anketë në mënyrë që të përcaktoj se cilat sporte i tërheqin më shumë studentët.

Përmirësimet e infrastrukturës në objektet sportive në kampus ishin të gjera. Nga ku mund të veçojmë: adaptimi i ndërtesës 818, për përfshirjen pajisjeve për gjimnastik, blerja e mjeteve për fitnesit, rinovimi i fushave (tenis, basketboll, volejball), dhe përforsim i ndriçimit për ato zona. Këto rezultate të kombinuara kanë dhënë një rritje të konsiderueshme të pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete sportive.

Edhe këtë vit akademik, në fund të semestrave (atij të vjeshtës dhe të pranverës) janë organizuar gara në futboll të vogël, basketboll, tenis, shah dhe ping-pong. Në javën e evenimentit „Dita e hapur” e UEJL-së është organizuar garë në futboll të vogël për nxënësit e shkollave të mesme të rajonit të Tetovës me pjesëmarrje të të gjitha shkollave nga rajoni.

Universiteti ka qenë aktiv edhe në kampionatin universitar që organizohet nga Federata sportive universitare e R. Maqedonisë, edhe atë me disa ekipe si ai i basketbollit, ping-pongut dhe shahut. Në nivel shtetëror, ekipi i futsallit vazhdon pjesëmarrjen në Kampionatin republikan me sukses të dalluar. Kemi zhvilluar interesin tonë në çiklizmin rekreativ. Në këtë aktivitet, studentët edhe stafi bëjnë çiklizëm në shtigje të ndryshme në rajonin e Tetovës. Aktivitet tjetër sportiv që vlen të përmendet është alpinizmi dhe skitaria; UEJL e ka fituar garën e 6 ndëruniversitare në Kodrën e Diellit.

10 Përfundimi

Si kudo tjetër në këto kohë të vështira për institucionet e arsimit të lartë, Universiteti i Evropës Juglindore mbetet institucion atraktiv, ndërkombëtarisht i njohur për të studiuar. UEJL i mbetet besnik vizionit të themeluesve, duke vazhduar me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, në të tri gjuhët që përdoren në nivel të universitetit për të gjithë studentët, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, fetare ose gjinore.

Megjithatë, duhet pranuar se një institucion serioz duhet të pranojë ballafaqimin me sfidat dhe duhet të punojnë në kapërcimin e tyre. Universiteti edhe më tej mbetet një ofertë e shtrenjtë akademike, së paku në aspektin lokal, duke e vështirësuar pagesën e shkollimit për disa familje, të cila nuk arrijnë ta përballojnë këtë depresion ekonomik mbarëbotëror. Universiteti, gjithashtu ballafaqohet edhe me konkurrencën në rritje nga disperzimi i universiteteve shtetërore, degët e të cilëve janë vendosur gjithnjë e më shumë në vende të padenja, nga ku në të kaluarën UEJL ka pasur studentë. Universiteti ka shënuar rënie në masë të madhe në studimet deridiplomike, me sa duket, për shkak të dy faktorëve të mësipërm-dhe çdo fakultet ka rritur përpjekjet promovuese dhe komunikimin me komunitetin në terren, në mënyrë që të ndihmojë në regjistrimin e studentëve të rinj.

Ky raport regjistron suksese dhe të arritura të shumta, por ka disa rekomandime me vend për përmirësim. Disa sugjerime shfaqen në seksionet individuale të këtij raporti. Kjo listë është më e përgjithshme dhe plotësuese. Kjo listë nuk bën katalogjizimin dhe nuk rendit sipas rëndësisë këto rekomandime, prandaj kjo do të jetë pune e Universitetit për dhënien përparësisë së këtyre rekomandimeve:

- të rritet regjistrimi i studentëve në studimet deridiplomike dhe të ruhet numri i regjistrimeve në studimet pasdiplomike;
- të përmirësohen burimet dhe teknologjitë elektronike, veçanërisht në aspekt të hulumtimit dhe bazës së të dhënave të hulumtimit;
- të përmirësohen kontaktet, aktivitetet dhe promovimi me Alumnin;
- të përmirësohet dhe të zgjerohen kontaktet me palët e interesuara, veçanërisht në lidhje me përmirësimin e punësimit të të diplomuarve;
- të rritet lëvizshmëria e studentëve dhe stafit, si dhe partneritetet ndërkombëtare;
- të rritet shkalla e diplomimit të studentëve që diplomojnë në kohë.

Edhe pse këto sfida mund jenë të vështira, Universiteti i mirëpret ato, sepse përmbushja e të njëjtave paraqet një përmirësim në shërbimet që ne ofrojmë për studentët tanë, stafin dhe komunitetin. UEJL ka një reputacion të mirë dhe një angazhim të fortë konceptual për të cilat u themelua: shumëgjuhësinë, multikulturalizmin dhe arsimin.

Edhe pse rritja e konkurrencës dhe vështirësitë ekonomike botërore i bëjnë zgjidhjet më të vështira, UEJL mbetet një institucion dinamik, largpamës që nxjerr të diplomuar të shkathtë dhe punëson staf akademik të dalluar dhe administratorë të shkathtë.

Anëtarët e Komisionit të vetëvlerësimit

- Provosti
- Sekretari i përgjithshëm
- Këshilltarja ekzekutive për cilësi
- Përgjegjësi i Qendrës së UEJL-së Shkup
- Përgjegjësi i Shërbimeve studentore
- Përfaqësuesit e pesë fakulteteve
- Drejtorja e Qendrës së gjuhëve
- Drejtorja e Qendrës së mësimin në distancë (eLearning)
- Asistentja e Zyrës për sigurimin e cilësisë (për mbështetje teknike)